

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7113
E premte, 9 shkurt 2024
Çmimi 0.50 €

Konjufca: Dinari ka qenë instrument që është përdorur për t'i manipuluar serbët e Kosovës | FAQE 4



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VENDIMI PËR KËMBIMIN E TOKAVE DHE SHKARKIMET PRISHIN
KOALICIONIN PDK-LDK NË PRISHTINË | FAQE 4-5

PDK-ja I JEP FUND KOALICIONIT ME LDK-NË NË PRISHTINË



Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i ka dhënë fund koalicionit me Lidhjen Demokratike të Kosovës në Prishtinë. Vendimi për prishjen e koalicionit ka ardhur në ditën kur është shfuqizuar vendimi për këmbimin e tokave

në Badovc dhe disa ditë pas shkarkimit të drejtorit dhe të nënkryetares së kryeqytetit nga kryetari Përparim Rama. Ismaili ka thënë se nuk do të jenë pjesë e një qeverisjeje që dëmton interesin publik dhe ku nuk

vlerësohet puna e mirë dhe meritokracia përbuzet. "Duke mos dashur asnjëherë që Prishtina të bllokohet, jemi tërhequr nga të gjitha pozitat për të hapur rrugë për krijimin e një shumice të re në kryeqytet", ka njoftuar Ismaili

PUSHTETI NUK E PËRKRAH REZOLUTËN PËR ULJEN E ÇMIMIT TË RRYMËS

Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje nuk e kanë përkrahur propozim-rezolutën e opozitës për uljen e çmimit të rrymës në Kosovë. 29 deputetë të

opozitës kanë votuar në favor të kësaj rezolute, ndërsa 55 deputetë të pushtetit kanë abstenuar. Ndaj këtij abstenimi ka reaguar lideri i PDK-së,

Memli Krasniqi, i cili ka thënë se varfërimi dhe përbuzja e qytetarëve janë qëllimet e vetme të pushtetit aktual në Kosovë



AKTUALE



PËRPLASJE NË KUVEND, TAHIRI DHE HAXHIU SHKËMBEJNË AKUZA PËR BASHKËPUNIM ME RADOIÇIQIN | F. 5

ÇFARË BËJNË KOMUNAT PARALELE SERBE NË KOSOVË? | F. 5

SVEÇLA: SIGURIA E KOSOVËS ËSHTË SFIDUAR NGA SATELITI I RUSISË, SERBIA | F. 4

EKONOMI



NËNSHKRUHET KONTRATA PËR ZGJERIMIN E RRUGËS PRISHTINË - MITROVICË | F. 8

TAHIRI: PAGA MINIMALE NË KOSOVË TË JETË 400 EURO | F. 8

SPORT



ADEMI TAKOHET ME ÇEFERIN DHE INFANTINON, DELEGACIONI I FIFA-S DO TA VIZITOJË KOSOVËN | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kundërkandidatit të Putinit i ndalohej garimi në zgjedhje në Rusi

MOSKË, 8 SHKURT - Politikani opozitar rus Boris Nadezhdin, i cili haptazi ka bërë thirrje për ndaljen e pushtimit të Ukrainës nga Moska, ka thënë të enjten se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Rusisë nuk ka pranuar ta regjistrojë atë si kandidat për zgjedhjet presidenciale të 15 marsit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka thënë më herët se kishte gjetur "mangësi" në më shumë se 15 për qind të nënshkrimeve mbështetëse për kandidaturën e Nadezhdin.

Nadezhdin shkroi në Telegram se do të ankohej ndaj vendimit të komisionit në Gjykatën Supreme të Rusisë, duke ngulur këmbë se të gjitha 200 000 nënshkrimet e mbështetësve të tij ishin mbledhur në mënyrë "të hapur dhe të drejtë".

"Vendimi për të garuar për president më 2024 ishte vendimi më i rëndësishëm politik në jetën time. Unë nuk do të heq dorë nga qëllimet e mia. Do të ankojem

ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve", ka thënë Nadezhdin.

Nadezhdin, një 60-vjeçar i lindur në Uzbekistan, është përkrahur nga shoqatat e politikantit të burgosur opozitar Aleksei Navalny dhe figurat opozitare në mërgim, Maksim Kats dhe Mihail Khodorkovsky, megjithëse pritet janë që zgjedhjet do të fitohen me lehtësi nga presidenti Vladimir Putin, i cili e ka udhëhequr Rusinë si president apo kryeministër që prej vitit 1999.

Putini është regjistruar zyrtarisht kandidat për president në fund të janarit për zgjedhjet që pritet t'i fitojë pa ndonjë telash, sepse kundërshtarët e tij kryesorë ndodhen ose në burg ose në mërgim, pasi kanë ikur për arsye sigurie.

Zgjedhjet në Rusi kontrollohen fuqishëm nga Kremli dhe nuk janë as të lira e as të drejta.

Boris Nadezhdin, 60 vjeç, angazhohet për fundin e luftës në



Ukrainë dhe fundin e mobilizimit ushtarak, si dhe për dialog me Perëndimin. "Njerëzit nënshkruajnë për mua, jo sepse

u pëlqej në mënyrë të veçantë, por sepse është një shans për të bërë diçka për paqen, për t'i dhënë fund gjithë kësaj historie

dhe për t'i ndalur vrasjet e njerëzve", ka thënë Nadezhdin për agjencinë e lajmeve "Reuters" më 24 janar.

OKB-ja: Koreja e Veriut vodhi 3 miliardë dollarë nga sulmet kibernetike për të ndërtuar armë bërthamore

NJU-JORK, 8 SHKURT - Monitoruesit e sanksioneve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) po hetojnë dhjetëra sulme të dyshuara kibernetike nga Koreja e Veriut që grumbulluan 3 miliardë dollarë për ta ndihmuar atë ta zhvillojë më tej programin e saj të armëve bërthamore, sipas një raporti të pabotuar të OKB-së.

"Republika Popullore Demokratike e Koresë (DPRK) vazhdon t'i shpërfill sanksionet e Këshillit të Sigurimit", i ka thënë një grup vëzhguesish të pavarur një komiteti të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ekipi po heton 58 sulme të dyshuara kibernetike nga DPRK-ja ndaj kompanive të lidhura me tregun e kriptomonedhave midis 2017 dhe 2023 me një vlerë prej 3 miliardë dollarësh, një shumë që supozohet se ka ndihmuar në financimin e armëve të shkatërrimit në masë të DPRK-së. Misioni diplomatik i Koresë së Veriut në OKB nuk e ka komentuar



raportin, por në të kaluarën regjimi i Kim Jong Un ka mohuar akuzat se po rekruton hakerë për sulme kibernetike.

Siç kanë raportuar inspektorët e OKB-së, grupet e hakerëve të Koresë së Veriut, të cilat janë pjesë e agjencisë kryesore të

inteligjencës së jashtme të Phenianit, është thënë se kanë vazhduar të kryejnë një numër të madh sulmesh kibernetike.

Koreja e Veriut vazhdoi zhvillimin e mëtejshëm të armëve bërthamore dhe prodhoi materiale bërthamore, megjithëse testi i fundit i njohur bërthamor u zhvillua në vitin 2017, është thënë në raport, duke shtuar se Pheniani vazhdoi të lëshonte raketa balistike.

Këshilli i Sigurimit i OKB-së e ka ndaluar prej kohësh Korenë e Veriut të kryejë teste bërthamore dhe të lëshojë raketa balistike. Sanksionet janë vendosur ndaj Phenianit që nga viti 2006 dhe janë forcuar vazhdimisht nga Këshilli i Sigurimit në një përpjekje për t'i bllokuar fondet për programin e zhvillimit të armëve të shkatërrimit në masë të regjimit Kim.

Megjithatë, Këshilli i Sigurimit nuk ka gjasa të ndërmarrë veprime të mëtejshme kundër Koresë së Veriut, pasi ajo është bllokuar prej disa vitesh për këtë çështje, me Kinën dhe Rusinë që bëjnë thirrje për lehtësimin e sanksioneve.

Turqia merr ndihmë financiare nga BE-ja në vlerë prej 400 milionë eurosh

ANKARA, 8 SHKURT - Turqia do të pranojë një ndihmë financiare në vlerë prej 400 milionë eurosh nga Bashkimi Evropian pas tërmeteve shkatërruese që goditën Turqinë një vit më parë. Kjo është shifra më lartë që ka ndarë ndonjëherë Fondi për

Solidaritetin e BE-së për ndonjë shtet kandidat, njoftoi të mërkurën komisionarja evropiane Elisa Ferreira pas nënshkrimit të marrëveshjes financiare.

Paratë e kësaj pakoje të ndihmës do të përdoren për

restaurimin e infrastrukturës dhe për strehim urgjent. Po ashtu, paratë do të përdoren për ta mbrojtur trashëgiminë kulturore të Turqisë. Nga tërmetet e fuqishme të 6 shkurtit të vitit 2023 vranë mbi 60 000 persona në Turqi dhe në

Sirinë fqinje. Pak pas kësaj tragjedie, BE-ja ishte zotuar se do ta ndihmojë shtetin me 1 miliard euro gjatë një konference të donatorëve. Fondi i ndarë prej 400 milionë eurosh është pjesë e kësaj pakoje të ndihmës.



VENDIMI PËR KËMBIMIN E TOKAVE DHE SHKARKIMET PRISHIN KOALICIONIN PDK-LDK NË PRISHTINË

PDK-ja i jep fund koalicionit me LDK-në në Prishtinë

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i ka dhënë fund koalicionit me Lidhjen Demokratike të Kosovës në Prishtinë. Vendimi për prishjen e koalicionit ka ardhur në ditën kur është shfuqizuar vendimi për këmbimin e tokave në Badoc dhe disa ditë pas shkarkimit të drejtorit dhe të nënkryetares së kryeqytetit nga kryetari Përparim Rama. Kryetari i Degës së PDK-së në Prishtinë, Uran Ismaili ka thënë se nuk do të jenë pjesë e një qeverisjeje që dëmton interesin publik dhe ku nuk vlerësohet puna e mirë dhe meritokracia përbuzet. “Duke mos dashur asnjëherë që Prishtina të bllokohet, jemi tërhequr nga të gjitha pozitat për të hapur rrugë për krijimin e një shumice të re në kryeqytet”, ka njoftuar Ismaili

EPOKA
ERE

Lirim GECI

Prishtinë, 8 shkurt - Kryetari i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prishtinë, Uran Ismaili, ka njoftuar se e kanë prishur koalicionin qeverisës me LDK-në në Prishtinë.

Ismaili në “Facebook” ka shkruar se i ka dorëzuar shkresën zyrtare për prishje të koalicionit, kryetarit Përparim Rama. “Pasi shfuqizuar vendimin për Badoc, shkëpusim koalicionin qeverisës në Prishtinë. Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Prishtinës sot, PDK-ja mundësoi kuorumin dhe votoi pro shfuqizimit të vendimit për këmbimin e dëmshëm të pronave në Badoc. Sapo dërgova shkresën zyrtare te Përparim Rama për ta komunikuar vendimin për shkëputjen e koalicionit qeverisës në Prishtinë. Drejtorët e drejtorive komunale dhe aksionarët e PDK-së në ndërmarrje publike kanë dhënë dorëheqjet e tyre”, ka shkruar Ismaili.

Ai ka shtuar se për dy vjet shërbim, ekipi i PDK-së ka sjellë një dinamikë të re në kryeqytet dhe ka bërë punë të jashtëzakonshme në secilin dikaster. “Nën udhëheqjen e shkëlqyer të nënkryetares Sahatçiu, drejtoritë e udhëhequra nga PDK-ja janë vlerësuar si drejtoritë me performancën më të mirë, brenda dhe jashtë. Gjallërinë, sinqeritetin, pozitivitetin dhe dinamikën që e kishim në fushatën tonë ‘Prishtina na Bashkon’ e kemi përçarur edhe

në qeverisjen e kryeqytetit dhe qytetarët janë dëshmitarët më të mirë për këtë gjë”, ka shkruar Ismaili.



Ismaili ka shtuar se nuk do të jenë pjesë e një qeverisjeje që dëmton interesin publik, ku mungon komunikimi, ku puna e mirë nuk vlerësohet dhe meritokracia përbuzet. “Duke mos dashur

asnjëherë që Prishtina të bllokohet, jemi tërhequr nga të gjitha pozitat për të hapur rrugë për krijimin e një shumice të re në kryeqytet”, ka shkruar ai. Kujtojmë se PDK në këtë koalicion

qeveritar kishte ardhur pas një rezultati befasisht të mirë në zgjedhjet e 31 tetorit 2021 për asamble komunale. Kjo parti politike i kishte fituar 9 asamblistë, ose vetëm pesë më pak se LDK-ja.

Prishja e koalicionit ka ardhur pas shkarkimit të Ilirik Musliut nga pozita e drejtorit të Shërbimeve Publike dhe nënkryetares Donjeta Sahatçiu nga kryetari Përparim Rama.

Kuvendi Komunal i Prishtinës anulon vendimin për këmbimin e tokave

Në një seance të jashtëzakonshme, Kuvendi Komunal i Prishtinës ka anuluar vendimin e mëhershëm për këmbimin e pronave komunale me ato private.

Me 27 vota për, asamblistët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe të PDK-së në Prishtinë e kanë anuluar vendimin e ndërrimit të tokave të komunës në “Prishtina e re” dhe disa toka private në Babovc. Ky veprim është marrë pas raportimeve të medieve dhe reagimit të fuqishëm të opinionit. Kjo seancë e jashtëzakonshme për shfuqizimin e këtij vendimi ishte thirrur me kërkesë të LV-së dhe mbështetje të PDK-së e cila është në koalicion qeverisës me LDK-në

në kryeqytet.

Kryetari Përparim Rama para se ta lëshonte sallën, së bashku me asamblistët e LDK-së, ka thënë se ky vendim ka rrjedhur nga një proces i cili ka filluar nga qeverisja e kaluar. “Për më tepër, ky proces ka rrjedhur nga një numër i vendimeve të nivelit qendror, pra Ministrisë së Ambientit, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal. Nga momenti që qeverisja jonë ka vazhduar këtë proces janë ndjekur të gjitha procedurat e parapara ligjore. Pra, për këtë çështje janë dërguar pikat e rendit të ditës me kohë, përfshi këtë pikë për këmbim”, ka deklaruar Rama.

Konjufca: Dinari ka qenë instrument që është përdorur për t'i manipuluar serbët e Kosovës



Prishtinë, 8 shkurt - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se dinari ka qenë instrument që është përdorur për t'i manipuluar serbët e Kosovës. Ai ka thënë se Serbia nëpërmjet Listës Serbe ka dërguar dinarë nëpër shtëpitë e serbëve të Kosovës. Më tutje, Konjufca para medieve ka thënë se ka qenë e domosdoshme që shteti ynë të ndërhyjë sepse kjo i ndihmon integritet të serbëve. “Dinari nuk ka qenë

thjesht valutë, monedhë. Dinari ka qenë instrument të cilin dikush ta ka sjellë fizikisht nga Beogradi me kombi, e aty do zyrtarë të Vuçiqit përmes Listës Serbe të kanë ardhur te shtëpia dhe t'i kanë dhënë paratë, edhe e kanë kërkuar lojalitetin tënd për Listën Serbe. Kjo është arsyeja fizike e shpërndarjes së dinarit. Do të thotë, po kuptojmë se këtu nuk është thjesht beteja e jo mirëqenia, jo tensionet. Është, thjesht,

ushtrimi praktik, konkret edhe fizikisht i Listës Serbe dhe i Beogradit te secila familje, të 88 mijë të ardhura që vijnë dhe shkojnë drejt tek shtëpitë e tyre në mënyrë fizike. Pra, për këtë arsye, ka qenë e domosdoshme që shteti ynë të ndërhyjë sepse kjo i ndihmon integritet të serbëve, po e godet pikërisht atë manipulim fizik, që me iu shkuar njerëzve në shtëpi se kë e mbështesin. Tash kurrkush nuk të vjen te shtëpia”, ka thënë Konjufca.



Çfarë bëjnë komunat paralele serbe në Kosovë?

PRISHTINË, 8 SHKURT - Hyrja e kryetarëve shqiptarë në objektet komunale në Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok nuk i shoi institucionet paralele serbe atje, por vetëm nxitë transferimin e tyre në objekte të tjera. Në këto tri komuna me shumicë serbe në veri të Kosovës, institucionet e Kosovës dhe strukturat paralele të Serbisë funksiononin në të njëjtin objekt.

Madje, në disa raste, si në atë të Leposaviqit, i njëjti person shërbente si kryetar i dy institucioneve. Tani që Lulzim Hetemi është kryetar i komunës së Leposaviqit, Zoran Todiç kryen punën e kryetarit të institucionit paralel serb prej një objekti në tjetër. Por, kjo formulë nuk vlen për të gjitha komunat. Në sistemin e Kosovës, Mitrovica e Veriut dhe ajo e Jugut janë dy komuna të ndara, ndërsa sipas sistemit paralel serb, ekziston vetëm e ashtuquajtura komunë e Mitrovicës së Kosovës. Që të tria sot funksionojnë në objekte të ndryshme. Në disa rajone, kryesisht rurale, strukturat paralele funksionojnë nëpër shtëpi të marra me qira.

Çfarë janë strukturat paralele?

Ato janë institucione që funksionojnë në Kosovë që nga paslufta, me mbështetje

financiare dhe me direktiva nga Qeveria e Serbisë, e cila nuk e njeh shtetësinë e Kosovës. Për Serbinë ato janë "organe të përkohshme". Për Kosovën janë struktura ilegale, në kundërshtim me Kushtetutën, prandaj ajo i ka mbyllur shtatë të tilla ditët e fundit. Që nga viti 1999 në Kosovë funksionojnë afër 30 komuna paralele. Koka e tyre është Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë.

Teksa zgjedhjet për këto komuna paralele nuk janë mbajtur prej vitit 2012, kryetarët e tyre i emëron ekzekutivi në Serbi. Në kuadër të komunave, kryesisht në veri të Kosovës, ekzistojnë edhe dhjetëra ndërmarrje publike, kopshte për fëmijë, shkolla fillore e të mesme, universitete publike, klube sportive, biblioteka, qendra kulturore e të tjera.

Çfarë shërbimesh ofrojnë?

Një pjesë e strukturave paralele i kanë uebfaqet e tyre, ose llogaritë në rrjete sociale. Disa faqe janë aktive - e Leposaviqit, e Zubin Potokut dhe e Mitrovicës - disa jo. Në terren, komunat me shumicë serbe në veri janë shumë më të zgjeruara. Ato vendosin edhe

për ndërtimin e objekteve banesore për personat e zhvendosur, për çiftet e sapomartuara dhe për personat me kushte jo të mira ekonomike, si dhe për rindërtimin e rrugëve dhe renovimin apo ndërtimin e institucioneve arsimore e shëndetësore. Këto komuna paralele kanë departamente për inspektim, për ekonomi dhe financa, dhe për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore. Ato i pajisin qytetarët në Kosovë me certifikata të lindjes e të vdekjes, me autorizime e me dokumente të ngjashme.

Cilat janë detyrat kryesore të tyre?

Të ofrojnë shërbime për qytetarët në Kosovë. Sipas presidentit serb Aleksandër Vuçiq, Serbia ka në Kosovë 31 831 persona të punësuar, 29 115 pensionistë dhe 31 586 shfrytëzues të ndihmës sociale, të cilët i paguan në dinarë serbë. Pagat në fushën e arsimit dhe në atë të shëndetësisë kalojnë përmes Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë. Sipas një projektstatuti të hartuar nga Perëndimi për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, institucionet serbe të shëndetësisë dhe të arsimit – që

janë paralele dhe jo të paligjshme – janë paraparë të regjistroheshin si institucione private.

Pagat dhe angazhimi

Në institucionet paralele të arsimit dhe të shëndetësisë punonjësit marrin paga dukshëm më të mëdha, sepse shteti serb ndan për ta një shumë shtesë, përveç pagës. Për shembull, infermierët mund të marrin pagë deri në 1 200 euro, kurse mjekët deri në 3 000 euro, ndërsaq punonjësit e arsimit nga 900 euro deri në 1 300 euro. Sipas sistemit të Kosovës, mjeku i përgjithshëm e ka pagën 777 euro, ndërsa mësuesi në shkollën e mesme 609 euro.

Për dallim prej strukturave paralele në veri, në zonat që kanë pak serbë, në jug të Ibrit - shembull në Kaçanik e Suharekë - pjesa më e madhe e punëtorëve nuk dihet as se çfarë bëjnë. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal në Kosovë e lejon dërgimin e ndihmave financiare nga Serbia. Shteti serb i ka ndarë 139 milionë euro për serbët në Kosovë për vitin 2024 - rreth 11 milionë më shumë sesa më 2023. Disa ekspertë kanë dilema për këto shuma, duke thënë se investimet e Serbisë në Kosovë kanë qenë jotransparente ndër vite. /REL/

Sveçla: Siguria e Kosovës është sfiduar nga sateliti i Ruisë, Serbia

PRISHTINË, 8 SHKURT - EULEX-i ka mbajtur të enjten ceremoninë e ndarjes së medaljeve për shërbim në politikën e përbashkët për siguri dhe mbrojtje për njësinë e vet policore të specializuar rezervë. Kjo njësi përbëhet prej 49 pjesëtarëve të Forcës së Xhandarmërisë Evropiane (EUROGENDFORCE) nga Italia, Lituania dhe Franca. Me këtë rast, Xhelal Sveçla, ministër i Punëve të Brendshme, ka thënë se siguria po rrezikohet për shkak të



etjeteve për luftë, ambicieve për pushtim e tendencave për destabilizim dhe minim të paqes.

Sveçla ka thënë se edhe siguria e Republikës së Kosovës është sfiduar shumë herë në dy vitet e fundit nga sateliti i Ruisë në rajonin tonë, Serbia. Sipas tij, brenda kësaj periudhe kemi pasur 112 sulme ndaj pjesëtarëve dhe aseteve të Policisë së Kosovës. "Këto sfida me të cilat vazhdojmë të ballafaqohemi akoma, kulmuan me kidnapimin e tre zyrtarëve tanë policorë thellë brenda territorit të Republikës së Kosovës, me sulmet brutale ndaj ushtarëve të KFOR-it e me

sulmin terrorist të 24 shtatorit ku mbeti i vranë zyrtari policor, rreshter Afrim Bunjaku", ka thënë Sveçla. Ndërsa Giovanni Pietro Barbano, shef i Misionit EULEX në Kosovë, ka thënë se ky mision ka për qëllim ofrimin e sigurisë pa dallim përkatësie etnike dhe llogaridhënies pa ndërhyrje politike dhe në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe praktikave më të mira evropiane.

Parlamenti Evropian miraton rezolutë për Serbinë, kërkon hetim ndërkombëtar për zgjedhjet

STRASBURG, 8 SHKURT - Me një rezolutë urgjente që ka miratuar të enjten, Parlamenti Evropian (PE) ka dënua parregullsitë që janë raportuar gjatë zgjedhjeve të fundit në Serbi, ka kërkuar hetim ndërkombëtar dhe ka bërë ftesë të kushtëzohet vazhdimi i procesit të negociatave të anëtarësimit me respektimin e standardeve demokratike të BE-së.

Serbia ka mbajtur zgjedhjet lokale, parlamentare dhe krahinore më 17 dhjetor 2023. Rezoluta ka marrë një mbështetje të fuqishme gjatë votimit. Në favor të rezolutës votuan 461 deputetë, nga 557 sa ishin të pranishëm, kundër ishin vetëm 53, ndërsa abstenuan 43.

Në tekstin e rezolutës, i cili ishte rezultat i bisedimeve të disa grupeve politike të PE-së, shprehet keqardhje për faktin se Serbia nuk ka siguruar zhvillimin e zgjedhjeve sipas standardeve dhe normave ndërkombëtare, si dhe për shkak të refuzimit të autoriteteve të Serbisë që të pranojnë se kanë ndodhur parregullsi në zgjedhje. "Bëjmë thirrje për hetime të pavarura nga ekspertë dhe institucione të respektuara ndërkombëtare për parregullsitë në zgjedhjet parlamentare, krahinore dhe lokale, me kujdes të posaçëm në zgjedhjet për Asamblenë e qytetit të Beogradit", është thënë në rezolutë.

Deputeti i Parlamentit Evropian, Andreas Schieder, i cili ka qenë

edhe anëtar i misionit vëzhgues evropian gjatë zgjedhjeve të 17 dhjetorit në Serbi, ka thënë se me këtë rezolutë i dërgohet mesazh i qartë presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, dhe partisë në pushtet, se duhet t'i respektojnë standardet demokratike ndërkombëtare dhe të marrin përgjegjësi për parregullsitë sistematike në procesin e zgjedhjeve.

Me këtë rezolutë, Parlamenti Evropian i ka bërë thirrje Komisionit Evropian që ta shqyrtojë dërgimin e një misioni ekspertësh në Serbi, për ta vlerësuar situatën dhe zhvillimet pas zgjedhjeve të fundit dhe të bëjë përpjekje për të lehtësuar një dialog shoqëror, i cili do të çonte deri te kthimi i besimit në institucione.

Parlamenti Evropian dënon mungesën e pluralizmit politik gjatë procesit zgjedhor, favorizimin e partisë në pushtet nga ana e medieve gjatë fushatës, fushatat e shumta të dezinformimit, në të cilat, sipas tekstit, ishin përfshirë mediet pro-qeveritare në Serbi, por edhe media dhe organizata nga Rusia. Ndër parregullsitë më të shpeshta në zgjedhjet në Serbi të zhvilluara më 17 dhjetor të vitit 2023, Parlamenti Evropian përmend votimin e shtetasve nga vendet e tjera, posaçërisht nga Bosnjë-Hercegovina në zgjedhjet lokale, sjelljen në mënyrë të organizuar të



votuesve në vendvotime nga partia në pushtet, shlyerjen e votuesve nga regjistri në disa raste, joshjen e paligjshme të votuesve dhe forma të tjera të shkeljeve të parimeve të zgjedhjeve të lira.

Në tekstin e rezolutës dënohet edhe përdorimi i tepruar i forcave policore në Serbi ndaj demonstruesve gjatë protestave kundër parregullsive në zgjedhje. Po ashtu, deputetët e Parlamentit Evropian kanë dënua edhe sulmet verbale nga përfaqësuesit e pushtetit në Serbi ndaj vëzhguesve nga BE-ja, si dhe pohimet se vende të BE-së ishin përfshirë në organizimin e protestave pas zgjedhjeve, pohime të cilat nuk janë dëshmuar në asnjë rast. "Parlamenti Evropian ka shprehur edhe keqardhje për atë që e ka quajtur 'mungesë e kritikave të zëshme nga Komisioni Evropian',

posaçërisht nga komisionari për zgjerim, në një varg dyshimesh për mashtrime zgjedhore në Serbi dhe bën ftesë që Komisioni t'i adresojë pa vonesa këto çështje që sollën deri te dyshimet", është thënë në rezolutë.

Shumë deputetë të Parlamentit Evropian, duke komentuar rezolutën e miratuar, kanë thënë se nga një shtet kandidat për anëtarësim në BE, siç është Serbia, duhet t'i respektojë vlerat e përbashkëta të demokracisë, e zgjedhjet e lira janë një prej standardeve themelore.

Rezolutat e Parlamentit Evropian nuk e kanë fuqinë obliguese për BE-në, por paraqesin një qëndrim politik të këtij institucioni të BE-së. Raportet e organizatave monitoruese vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë misionin e Organizatës për Siguri

dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), tregonin se kishte parregullsi zgjedhore në zgjedhjet e 17 dhjetorit në Serbi.

SNS-ja në pushtet dhe udhëheqja shtetërore i kanë hedhur poshtë këto akuza.

Më 18 dhjetor Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) njoftoi se zgjedhjet u përcollën me parregullsi, keqpërdorim të fondeve publike, dominim mediatic nga presidenti i shtetit, Aleksandër Vuçiq, fushata negative dhe përhapje frike.

Presidenti i Serbisë, Vuçiq, më herët i ka mohuar akuzat për parregullsi në zgjedhje dhe i ka refuzuar thirrjet për hetim ndërkombëtar lidhur me parregullsitë e supozuara në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe lokale.

Përplasje në Kuvend, Tahiri dhe Haxhiu shkëmbejnë akuza për bashkëpunim me Radoiçiqin

PRISHTINË, 8 SHKURT - Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri dhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, kanë shkëmbyer akuza dhe kundërakuzat në seancën e Kuvendit të Kosovës.

Akuzat dhe kundërakuzat kanë nisur në momentin që Tahiri e ka kritikuar pushtetin për pjesëmarrjen e kryeministrit Albin Kurti në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e cila është ftuar me kërkesë të Serbisë për çështjen e dinarit.

Ai ka thënë se kjo seancë është kënaqësi e Serbisë sepse përmes saj ata tentojnë ta poshtërojnë Kosovën.

"E vetmja seancë dhe kënaqësi e Serbisë është me ftuar mbledhjen e Këshillit të Sigurimit për Kosovën sepse aty në radhë të parë për Kosovën flet UNMIK-u, e pastaj flasin përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës. Gjithmonë me synimin me degraduar shtetin e Kosovës, synojnë me pas UNMIK-un të parët", ka thënë Tahiri.

Ai ka shtuar se në të kaluarën, pikërisht për shkak të poshtërimit të Kosovës, ishin pajtuar që në këto mbledhje Kosova të mos përfaqësohej në nivel të lartë.

"Në të kaluarën me ShBA-në dhe partnerët e tjerë që janë anëtarë të përhershme, siç janë Britania e Madhe dhe Franca, jemi



dakorduar që sa më ulët të përfaqësohet Kosova në atë nivel, pra mundësisht mos me shkuar as ministri i Jashtëm, as kryeministri, as presidenti, por ambasadori, sepse qëllimi i Serbisë është që Kosova me dalë pas UNMIK-ut. Pra, kjo është një kurth e Serbisë dhe ju bini në grackën e saj", ka thënë Tahiri, Tahiri e ka akuzuar qeverinë se në tri vjet qeverisje, Kosovës i ka sjellë vetëm sanksione. "Para vitit 2021 kanë ardhur 117 njohje dhe

asnjë njohje s'ka ardhur në kohën kur ju qeverisni. E fundit (njohja) ka ardhur prej kryeministri Avdullah Hoti. Ju e udhëhiqni Kosovën me çnjohje. Ju keni sjell sanksione, ne kemi sjellë 117 njohje", ka thënë Tahiri.

Menjëherë pas kësaj deklarate ka ndërhyrë ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu. "Nuk e pata në plan të flas, por më zgjoi vëmendjen deklarata e Abelardit, që tha me ne ka pasur njohje e me juve sanksione. Qytetarët me

të drejtë mund të pyesin se pse ka pas sanksione? Ka pas sanksione për shkak se për herë të parë kontrabanduesit, terroristët, kriminelët nuk janë lejuar të veprojnë në veri të vendit tonë siç kanë vepruar në kohën kur keni qeverisur ju", ka thënë Haxhiu. Ajo i ka thënë Tahirit se "ju i keni lejuar sjelljet agresive të Serbisë mbi territorin e Kosovës. Nuk është larg mendsh që disa prej qeveritarëve dhe ish-politikanëve kanë bashkëpunuar me

kontrabandistë, e keni toleruar Radoiçiqin dhe plot terroristë të tjerë".

Ministrja ka theksuar se kur Kosova ka treguar dhe ka dëshmuar që nuk do të tolerohen më këta, natyrisht që janë vendosur masat sepse nuk i ka pëlqyer dikujt, në këtë rast BE-së. Pas këtyre akuzave, ka reaguar Abelard Tahiri. "U tuta që s'pe merr fjalën meqenëse kem dytë bashkë në seancë, Abulenë. Është e çuditshme të dëgjosh një zyrtar duke thënë se BE-ja na ka vendos sanksione pse ne po vendosim rend dhe ligj", ka thënë Tahiri.

Në raport me akuzat e Haxhiut, Tahiri ka thënë se e vetmja që bashkëpunon me Milan Radoiçiqin është shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila. "Albulenë, në këtë Kuvend vetëm për një njeri e dimë që koordinohet me Radoiçiqin, vetëm për shëfën e grupit tuaj parlamentar. Ju Radoiçiqin e keni pas në dorë, e keni parë me dron në kohë reale dhe ai ecte ngadalë dalë dhe doli prej Kosovës si zotëri. Ju duhet kësaj t'i jepni përgjigje se qysh e lejuat Radoiçiqin me dalë pa therë në këmbë prej një akti terrorist që bëri në Kosovë. Ju e keni ditur ku është dhe e keni lejuar të largohet", ka thënë Tahiri.

Haxhiu: Për tri vjet mbi 3 000 profesionistë shëndetësorë kanë ikur nga Kosova

PRISHTINË, 8 SHKURT - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bekim Haxhiu, ka thënë se profesionistët shëndetësorë janë duke ikur nga vendi. Ai në seancën e Kuvendit të Kosovës ka thënë se për tri vjet mbi tre mijë profesionistë shëndetësorë e kanë lëshuar

vendin. Sipas tij, nëse vazhdon një trend i tillë, sistemi shëndetësor do të kolapsojë. "Për tri vjet mbi 600 mjekë, mbi 2 500 infermierë, fizioterapeutë, teknikë të radiologjisë, teknikë mjekësorë, kanë ikur. Pra, janë më shumë se 3 100 profesionistë shëndetësorë që kanë ikur nga Kosova në

tri vitet e fundit. Kjo është shumë shqetësuese. Nëse ky trend vazhdon me këto shifra alarmante të ikjes së profesionistëve shëndetësorë, sistemi ynë shëndetësor do të kolapsojë. Prandaj është koha që koka të kthehet nga shëndetësia jonë, sa nuk është bërë tepër vonë", ka thënë Haxhiu.



6 vjet e 4 muaj burgim ndaj pesë ish-zyrtarëve të KEK-ut të akuzuar për korrupsion

PRISHTINË, 8 SHKURT - Ish-zyrtarët e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Zeqir Gashi, Qazim Reqica, Rexhep Gashi, Agron Hajrizi dhe Nazmi Musliu, janë dënuar me 6 vjet e 4 muaj burgim (së bashku) për veprën penale "Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar". Ndërsa i akuzuari Tefik Hargaja është liruar nga akuza për mashtrim. Nazmi Musliu bashkë me Zeqir Gashin, Rexhep Gashin, Agron Hajrizin dhe Qazim Reqicën akuzoheshin se kanë dëmtuar KEK-un në vlerë prej 53 mijë eurosh, duke keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare. Ndërsa për veprën penale të mashtrimit akuzohej Tefik Hargaja, raporton "Betimi për Drejtësi".

Aktgjykimi ndaj të akuzuarve është shpallur të enjten në Gjykatën Themelore në Prishtinë nga gjykatësi Ngadhjnim Arrni. Sipas aktgjykimit, të akuzuarit Zeqir Gashi, Qazim Reqica dhe Rexhep Gashi janë dënuar me nga një vit burgim. Të akuzuarit Agron Hajrizi dhe Nazmi Musliu janë dënuar me nga 1 vit e 8 muaj burgim, ndërsa i akuzuari

Hargaja është liruar nga akuza. Gjykatësi Arrni ka njoftuar palët se arsyetimin e shkruar do ta pranojnë brenda afatit ligjor, kurse palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në afat prej 30-ditësh pas pranimit të aktgjykimit në formë të shkruar.

Ndryshe, aktakuza e ushtruar në nëntor të vitit 2018, nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, ngarkonte Zeqir Gashin, Qazim Reqicën dhe Rexhep Gashin, se kanë shfrytëzuar detyrën zyrtare në KEK - Obiliq, duke pranuar nga operatori ekonomik "Univers-M" katër reduktorë të 15 KW nga pozicioni i 33, i të njëjtës kontratë, mall ndryshe me atë të kërkuar në kërkesë dhe të shkruar në fletëdërgesë dhe në fatura.

Me këtë, në bashkëkryerje të pandehurit akuzoheshin se kanë kryer veprën penale "Keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar" nga neni 422, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal, vepër kjo e dënuar me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.



Më tutje, sipas aktit akuzues, me datë, kohë dhe vend të njëjtë i akuzuari Agron Hajrizi, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore ka shfrytëzuar detyrën zyrtare, ku si person përgjegjës për përcjelljen e kontratës nga autoriteti kontraktues nuk e ka bërë përcjelljen e saj ashtu siç është e rregulluar me ligj dhe në këtë mënyrë ka mundësuar blerjen e katër reduktorëve të 15KW nga pozicioni i 33-të i të

njëjtës kontratë. Gjithnjë sipas aktakuzës, në maj të 2016-s, në KEK - Obiliq, i akuzuari Nazmi Musliu, duke shfrytëzuar detyrën zyrtare si person përgjegjës për përcjelljen e kontratës nga autoriteti kontraktues, ka nënshkruar kërkesën për blerjen e katër reduktorëve të 14 KW nga pozicioni i 11-të i kontratës me çmim prej 16 mijë eurosh për copë, edhe pse në të njëjtën

kontratë në pozicionin 33 kishte reduktorë të 15 KW me çmim prej 2 mijë e 600 euro për copë. Me këtë, Hajrizi dhe Musliu akuzoheshin se kanë kryer veprën penale "Keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar" nga neni 422, paragrafi 1 i Kodit Penal, vepër kjo e dënueshme me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Ndërsa Tefik Hargaja akuzohej se si person përgjegjës mashtron KEK-un si autoritet kontraktues, duke dorëzuar katër reduktorë të 15-të të pozicionit 33 me çmim prej 2 mijë e 600 eurosh për copë, ndërsa i kishte faturuar si në kërkesën e Autoritetit Kontraktues - KEK, me fletëdërgesë me çmim prej 16 mijë eurosh për copë ashtu siç ishte në pozicionin nr. 11 të kontratës, duke i shkaktuar dëm buxhetit të KEK-ut në vlerë prej 53 mijë euro.

Me këtë, i pandehuri Hargaja ngarkohej se e ka kryer veprën penale "Mashtrimi" sipas nenit 335, paragrafi 5 të Kodit Penal, vepër kjo që dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

Kuvendi s'ka kuorum për votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare



PRISHTINË, 8 SHKURT - Në seancën e Kuvendit të Kosovës nuk kanë arritur të votohen marrëveshjet ndërkombëtare, pasi në seancë ishin vetëm 65 deputetë, numër i pamjaftueshëm për t'i votuar ato. Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se përderisa nuk ka ndonjë

marrëveshje në mes të pozitës dhe opozitës që këto marrëveshje të kalojnë, këto pika nuk mund të vendosen në votim. "Vetëm 65 deputetë jemi. Nuk kemi mundësi t'i votojmë marrëveshjet ndërkombëtare. Nuk po shoh që kemi as mobilizim në mes të grupeve parlamentare që të

votohen. Pa një marrëveshje në mes të pozitës dhe opozitës nuk ka mundësi që këto të votohen. Me sa po e shoh prej gjendjes faktike, nuk janë arritur këto bisedime. Prandaj i kalojmë të gjitha këto marrëveshje ndërkombëtare", ka thënë Konjufca.

IKShPK-ja: Gripi në Kosovë, nën pragun epidemik

PRISHTINË, 8 SHKURT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gripi në Kosovë është nën pragun epidemik. Ky institut ka njoftuar se intensiteti i gripit sezonal, sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 5-të të vitit 2024, që paraqet periudhën 29 janar - 4 shkurt 2024, ka shënuar rënie

prej 16.02-përqindësh krahasuar me javën paraprake dhe është nën pragun epidemik.

"Megjithatë, janë duke u regjistruar ende raste të infeksioneve të tjera sezonale sikur sëmundje të ngjashme me grip (ILI), raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe raste me Infeksion të

rëndë respirator akut (SARI)", ka njoftuar IKShPK-ja.

Me këtë rast, IKShPK-ja u ka bërë thirrje qytetarëve, në veçanti grupeve të rrezikuara, siç janë të moshuarit, personat me sëmundje shoqëruese kronike, profesionistët shëndetësorë, shtatzënat, etj., të vaksinohen dhe t'i zbatojnë masat e tjera të kujdesit.



Pushteti nuk e përkrah rezolutën për uljen e çmimit të rrymës

Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje nuk e kanë përkrahur propozim-rezolutën e opozitës për uljen e çmimit të rrymës në Kosovë. 29 deputetë të opozitës kanë votuar në favor të kësaj rezolute, ndërsa 55 deputetë të pushtetit kanë abstenuar. Ndaj këtij abstenimi ka reaguar lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, i cili ka thënë se varfërimi dhe përbuzja e qytetarëve është qëllimi i vetëm i pushtetit aktual në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 SHKURT - Kuvendi i Kosovës ka dështuar ta miratojë të enjten një draft-rezolutë të propozuar nga opozita për uljen e çmimit të energjisë elektrike, pasi deputetët e partisë në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, kanë abstenuar. Me 29 vota për, asnjë kundër dhe 55 abstenime, draft-rezoluta nuk i ka marrë votat e nevojshme.

Lidhur me këtë çështje ka reaguar kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi. Ai ka thënë se është i turpshëm dështimi i miratimit të kësaj rezolute, duke thënë se pushteti po i mbron Martin Berishajn dhe Nagip Krasniqin. "Është vërtet i turpshëm dështimi i miratimit të rezolutës së propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës përmes së cilës kemi kërkuar anulimin e vendimit për shtrenjtimin e

energjisë elektrike dhe heqjen e bllok-tarifës. Natyrisht, atyre që e mbrojnë në çdo mënyrë e me çdo kusht Martin Berishajn e Nagip Krasniqin, nuk iu bëhet vonë për ankesat e shumë konsumatorëve që kanë pranuar e paguar fatura me çmime enorme përgjatë këtij dimri. Abstenimi i deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje nga votimi i kësaj Rezolute - është një tjetër dëshmi se varfërimi dhe përbuzja e qytetarëve të Kosovës është qëllimi i vetëm i këtij pushteti", ka shkruar Krasniqi në "Facebook". Kjo është hera e dytë që kjo draft-rezolutë, e propozuar nga Partia Demokratike, Lidhja Demokratike dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, dështon në Kuvend, pasi partia e kryeministrit Albin Kurti e kishte braktisur seancën e kaluar kur ajo pritej të hidhej në votim më 18 janar.

Rezoluta nuk ishte konsideruar serioze nga Lëvizja Vetëvendosje. Propozimi për uljen e çmimit të

rrymës kishte ardhur pasi shumë qytetarë ishin ankuar në rrjetet sociale gjatë dhjetorit se fatura e rrymës për muajin e fundit të vitit u kishte ardhur shumë më e lartë krahasuar me faturën e muajit paraprak, apo të të njëjtit muaj të vitit paraprak, duke ngritur shqetësime se çmimi i rrymës mund të jetë rritur.

Në atë kohë, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) kishte shpjeguar se vlera e faturës së muajit dhjetor është rritur si pasojë e "shpenzimit më të madh të rrymës" dhe mossubvencionimit të konsumatorëve kursimtarë nga Qeveria e Kosovës krahasuar me një vit më parë.

Përmes draft-rezolutës, kërkohej që Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike (ZRRE) dhe qeveria ta ulnin çmimin e energjisë "në harmoni me rrethanat socio-ekonomike dhe nivelin e çmimit të energjisë në tregun ndërkombëtar".

Ajo, gjithashtu, bënte thirrje për shfuqizimin e bllok-tarifës për konsumatorët familjarë. Ndërsa nga qeveria kërkohej që të ndërmarra masa për "krijimin e parakushteve financiare për anulimin e menjëhershëm të vendimit për shtrenjtimin e energjisë elektrike dhe lehtësimin e barrës financiare për konsumatorët familjarë të energjisë elektrike".

Cilat janë çmimet e rrymës?

Sipas tarifave të fundit, të miratuara në muajin prill nga ZRRE-ja, për konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kilovatë në orë brenda një muaji, çmimi gjatë ditës është 7.79 centë për kilovat, ndërsa për ata që shpenzojnë më shumë se 800 kilovatë, pjesa mbi këtë u llogaritet me çmim prej 14.45 centësh.

Nga ora 22:00 deri në 7:00 të mëngjesit çmimi për kilovat është 3.34 centë për ata që shpenzojnë deri në 800 kilovatë dhe 6.81 centë për atë që shpenzojnë më shumë. Çmimet kanë nisur të marrin hov në fillim të vitit të kaluar, kur Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës. Nga muaji shtator i vitit të kaluar deri në muajin prill të këtij viti Qeveria e Kosovës i ka subvencionuar konsumatorët që kanë kursyer së paku 5 për qind të rrymës në muaj, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Këta konsumatorë kanë përfituar dyfishin e përqindjes së kursyer. Në gusht, Instituti për Politika Zhvillimore - INDEP, i cili merret me çështje energjetike, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës ta vazhdojë subvencionimin e qytetarëve, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Sipas KESCO-s, mungesa e subvencionimit është një ndër arsyt përse qytetarët vërejnë rritje të faturave.

Kuvendi nuk i themeloi dy komisionet hetimore të propozuara nga PDK-ja

PRISHTINË, 8 SHKURT - Nuk ka arritur të votohet në Kuvendin e Kosovës formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për zjarret e dyshimta në Institutin e Mjekësisë Ligjore, zhdukjen e mostrave në rastin e Astrit Dehari dhe çdo veprimi e mosveprimi të Ministrisë së Drejtësisë që ka cenuar pavarësinë dhe përgjegjësitë ligjore të këtij instituti.

Siç ka bërë me dije kryeparlamentari Glauk Konjufca, në votim kanë marrë

pjesë vetëm 30 deputetë. "Vetëm 30 deputetë morën pjesë në votimin e këtij komisioni. Nuk pati kuorum. Kështu që në mungesë të kuorumit kjo bëhet pjesë e seancës së ardhshme", ka thënë ai.

Po ashtu, në mungesë të kuorumit, Kuvendi i Kosovës e ka shtyrë edhe votimin për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me nivelin e menaxhimit të marrëdhënies së punës të anëtarëve të shërbimit të

jashtëm dhe zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, të cilin e ka kërkuar deputetja e PDK-së, Ariana Musliu-Shoshi.

Komisioni në fjalë nuk është kundërshtuar nga asnjë parti politike. Derisa opozita ka kërkuar që ky komision të votohet të enjten, Lëvizja Vetëvendosje ka kërkuar që votimi i këtij komisioni të bëhet një ditë tjetër, kur do të ishte e pranishme edhe kryediplomatja Donika Gërvalla.



Prishtina pritet të lidhet me 'tren të lehtë' me Fushë-Kosovën dhe aeroportin

PRISHTINË, 8 SHKURT - Një tren i lehtë që lidh Prishtinën me Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës në Sllatinë është projekti i radhës i Ministrisë së Infrastrukturës, i cili është aprovuar për financim nga Bashkimi Evropian. Kështu ka bërë me dije ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu. Aliu ka thënë se treni do të kalojë nga Prishtina në Fushë-Kosovë dhe i njëjti

mundëson shkarkimin e trafikut në rrugën Prishtinë - Fushë-Kosovë. "E kemi projektin e hekurudhës nga Prishtina në Aeroportin e Prishtinës, e që është linjë hekurudhore që sapo është aprovuar. Është aprovuar nga BE-ja për financim, e kemi shtyrë si projekt i cili lidh Prishtinën me aeroportin e që kalon edhe në Fushë-Kosovë. Mundëson

shkarkimin e trafikut nga Fushë-Kosova në Prishtinë. Për projektet e tjera ndërlidhëse jemi në fazë të komunikimit me komunën e Prishtinës për unazën e Prishtinës. Kjo, mbase, do të fillojë të realizohet me segmente dhe është në fazë të përfundimit. Projekti i tillë është i rëndësishëm për shkarkimin e trafikut në kryeqytet", ka thënë Aliu.



Tahiri: Paga minimale në Kosovë të jetë 400 euro

PRISHTINË, 8 SHKURT - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për pagat në sektorin publik dhe në atë privat, të cilat, sipas tij, janë "tmerruese". Në fjalën e tij në Kuvendin e Kosovës, Tahiri ka thënë se rritja më e madhe e pagave ka ndodhur te kryeministri, ministrat dhe tek të emëruarit politikë. Sipas tij, rritja është mbi 50 për qind. "Për tri vjet rresht është diskutuar për pagat në sektorin publik dhe pagën minimale. Pagat në sektorin publik janë tmerr i tmerrit. Realisht rritje 80 për qind tek administrata e shërbyesit civilë ka vetëm prej 20 deri 40 euro. A e di ku është rritja më e madhe? Rritja më e madhe është te kryeministri, ministrat, tek të emëruarit politikë. Aty është bërë rritja më e madhe mbi 50 për

qind", ka thënë Tahiri.

Sipas Tahirit, paga e sektorit privat është ajo që ka qenë para 11 vjetësh. Më tutje, Tahiri ka kërkuar që paga minimale në Kosovë në sektorin privat të jetë 400 euro, ku në të përfshihen edhe veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). "Ndalem te paga në sektorin privat. Te qytetarët e Kosovës paga minimale është ajo që ka qenë para 11 vjetësh. Ne kemi kërkuar që paga minimale të jetë 400 euro dhe në të përfshihen edhe veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të cilët janë larguar nga ai ligj dhe tani ai ligj është në Gjykatë Kushtetuese", ka thënë Tahiri, duke e akuzuar qeverinë edhe për mosmiratimin e Ligjit për Sigurimet Shëndetësore. Ai ka thënë se jeta në Kosovë është duke



u varfëruar. "Pse nuk vjen sigurimi shëndetësor dhe cila është arsyeja që tri vjet nuk keni arritur të sjellim një ligj për sigurime shëndetësore? Reflektoni, edhe pse është viti i

fundit, por kjo duhet të jetë baza e diskutimit, e ballafaqimit dhe e llogaridhënies të kësaj qeverie. Aferim për çdo punë që e keni bërë në veri! Por, mos u mundoni me u

qitë hije syve të popullit për shkak se jeta është varfëri, ndërsa ekonomia është dobësuar", ka thënë Tahiri.

Ndërsa ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se Ligjin për Pagën Minimale e ka penguar opozita, konkretisht AAK-ja, e cila e ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese. "Sa i përket pagës minimale, më lejoni t'ju rikujtoj se paga minimale ka një vit e ca që ne kemi sjellë në Kuvend si qeveri. Është vonuar pikërisht në Kuvend, sepse opozita ka penguar votimin e pagës minimale. Megjithatë, në korrik të vitit të kaluar ligji që mundëson rritjen e pagës minimale ka kaluar në këtë Kuvend. Mirëpo është një subjekt politik që e ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese për ta penguar rritjen e pagës minimale", ka thënë ministri Murati.

Nënshkruhet kontrata për zgjerimin e rrugës Prishtinë - Mitrovicë

PRISHTINË, 8 SHKURT - Ministri i Infrastrukturës dhe Planifikimit Hapësinor, Liburn Aliu, ka njoftuar të enjten se e kanë nënshkruar kontratën për zgjerimin e rrugës që lidh Prishtinën me Mitrovicën. Aliu ka thënë se kjo rrugë është ndër projektet më të stërzgjatura që nga paslufta. "Sapo nënshkruam kontratën për zgjerimin dhe përfundimin e rrugës që lidh Prishtinën me Mitrovicën, projekt ky që ka qenë temë diskutimi për një kohë të gjatë, me probleme të shumta, mbase një ndër projektet më të stërzgjatura në historinë e pasluftës së Kosovës, por që jemi duke shkruar drejt përfundimit të tij.



Meqë arritëm ta nënshkruajmë kontratën, proces ky që ka filluar më 2 tetor kur është publikuar

njoftimi për dorëzimin e ofertave e që është paraprirë me disa faza të tjera si: angazhimi i kompanisë

mbikëqyrëse e në këtë rast e kemi të angazhuar kompaninë, procesi i përmbylljes, i shkëputjes së kontratës së vjetër që është paraprirë nga një proces i auditimit", ka thënë në një konferencë për medie. Më tutje, Aliu ka thënë se për këtë projekt janë ndarë 25 milionë euro, që janë marrë hua nga OPEC-u dhe në bashkëfinancim me Fondin Saudit për Zhvillim. "Bëhet fjalë për një projekt 25 milionë euro që është huamarrje nga fondi i OPEC-ut dhe në bashkëfinancimin me Fondin Saudit për Zhvillim, projekt ky që ka procedura të tjera dhe i njëjti ka qenë me autoritetet dhe faza e

deritanishme që jemi detyruar ta shkëpusim para një viti. Tash një vit është shkëputur kontrata që është paraprirë nga një procedurë e auditimit. Na zgjatën procedurat për një vit, por presim që të kemi rezultate të mira", ka thënë Aliu. Ndërsa zëvendësministri i Infrastrukturës, Hysen Durmishi, ka treguar se, sipas kontratës së re të nënshkruar për punën në rrugën Prishtinë - Mitrovicë, projekti duhet të përfundojë në fillim të vitit tjetër. "Do të kujdesemi për fazën e parë që punimet deri në Vushtrri të kryhen në pjesën e parë të vitit që në kohën kur të vijnë mërgimtarët pjesa e rrugës të jetë e përfunduar", ka thënë Durmishi.

Konfiskohen rreth 2 000 euro të falsifikuara, përfshirë monedha 5 dhe 100-euroshe

PRISHTINË, 8 SHKURT - Kosova tash e disa muaj është përbalhur me rritje alarmante të dukurisë së parave të falsifikuara, duke shkaktuar shqetësime të mëdha për autoritetet vendore dhe për sistemin financiar në përgjithësi. Paratë e falsifikuara kanë shkaktuar pasoja të mëdha për

ekonominë, sigurinë publike dhe integritetin e sistemit financiar në Kosovë. Vetëm në 24 orët e fundit policia ka konfiskuar 1 731 euro që dyshohet se janë të falsifikuara. Rasti i parë ka ndodhur në rrugën "Agim Ramadani" në Prishtinë. Ankuesja, menaxhere e bankës, ka njoftuar se në bankomatit e

tyre janë deponuar 870 euro që dyshohet të jenë të falsifikuara. Ndërsa një rast tjetër ka ndodhur në Fushë-Kosovë, ku ankuesja, punëtoare e bankës, ka njoftuar se në bankomatit e tyre janë deponuar monedha metalike me vlerë rreth 451 euro si dhe 2X5 euro të letrës të cilat dyshohet se janë të falsifikuara.



Pas 38 sulmeve ndaj artit, protestuesit ranë në grackë!



Nga: Giovanni ALOI,
ligjërues në Institutin e Artit
në Çikago
Përkthimi: Telegraft.com

Sa nga 38 protestat për mjedisin, të organizuara nëpër muzeume më 2022, mund t'i mbani mend? Sa nga ato më të fundit shkaktuan veçse zemërim më të gjerë? A çoi ndonjëra prej tyre në ndonjë ndryshim të prekshëm? Kauza e protestuesve është serioze, kërcënimi është shumë real, mesazhi është i rëndësishëm dhe urgjent. Por, a mos nuk po arrin te publiku? Gjashtëdhjetë vjet më parë, Kutitë e Brilllos të Andy Warholit dhe printimet e shumëfishta të Marilyn Monroes e ekspozuan përsëritjen moderne si ideal i pamend – një model kapitalist i pashmangshëm, i rrënjësor në mënyrat e mbingopura të prodhimit dhe konsumit që shpërqendrojnë dhe tronditin tekta ushqejnë ndjenjën e pakalueshme të apatisë moderne. Sa herë është shumë? Përsëritja është fenomen kompleks: mund të thellojë ose zbrazë përvojat, në varësi të mënyrës se si vendoset. Përsëritja ad libitum e çdo gjëje tronditëse, shpejt bëhet gjë e zakonshme. Të vetëdijshëm për rrezikun, artistët e mirë përpiqen të mos përsëriten; në vend të kësaj përpiqen vazhdimisht që të rishpikin. Nga Friedrich Nietzsche te Søren Kierkegaard,

Jean Baudrillard, Walter Benjamin, Mark Fisher, Frantz Fanon, Robert Hughes dhe Amia Srinivasan, mendimtarët modernë qëndronin gjerësisht në fuqitë gjithëpërfshirëse e qetësuese të përsëritjes së paqëllimtë. Goditja e së resë shkrihet shpejt në ajër. Supa me domate u spërkat mbi Lulediellin e Van Goghut dhe pureja e patateve u hodh te Mullari i sanës i Monetit – aktivistët e Last Generation dhe Just Stop Oil duan që ne t'i dëgjojmë ata. Objektivi i tyre është të na shpëtojnë nga nënshtrimi ndaj apatisë së zakonshme, të shkaktuar nga kapitalizmi që ka shtrembëruar shkallën tonë të vlerës. “Çfarë është më e rëndësishme? Arti apo e drejta për ushqim të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm?” – bërtitën dy protestues të Riposte Alimentaire pasi në muajin e kaluar spërkatën Mona Lizën me supën me kunguj. Por, protestat famëkeqe që përfshijnë ngjitesin, ngjyrën dhe hedhjen e ushqimit janë vetëm maja e ajsgbergut. Këto grupe të aktivistëve angazhohen në mënyrë rutine në përpjekjet vërtet të rëndësishme, shumica e të cilave shpërfillen nga mediat për mungesë sensacionalizmi. Protestë pas proteste, ndërgjegjësimi për këtë paragjykim mediatik i ka çuar demonstruesit antikapitalistë në një kurth të kërkimit të

vëmendjes: ata tani janë kapur në të njëjtat cikle të përsëritura të plogështisë së shkaktuar nga kapitalizmi, nga të cilat ata kërkuar të na çlironin të gjithëve. Një studim nga Apollo Academic Surveys, më 2023, tregoi se tekta taktikat përçarëse sigurisht që mund të ndihmojnë disa kauza, ato shpeshherë nuk gjenerojnë ndryshime kur ka probleme me ndërgjegjësim të lartë dhe me mbështetje të ulët. Mos shikoni më tej se rryma e pafund e komenteve fyese në platformat e mediave sociale, për të parë se si këto protesta kanë ndikuar negativisht në opinionin publik. Dhe, duke qenë se luftimi i krizës klimatike është përpjekje kolektive, serioziteti i këtij tjetërsimi publik nuk duhet nënvlerësuar. Një studim i publikuar nga klimatologu Michael E Mann në vitin 2022, tregoi se si rezultat i protestave, shumica e njerëzve ndjeheshin më pak të prirë se më parë për t'u bashkuar me nismat mjedisore. Protestat në muzeume i kanë kthyer shpejt aktivistët mjedisorë në ëndërrën e një kompanie të naftës. A mund të ndodhë që nuk po na dëgjojnë aktivistët që kaq shumë duan të dëgohen? Kjo shkëputje me publikun është shkaktuar nga mospërputhja midis vendit të protestës, mesazhit dhe objektivit të synuar që është thellë i rrënjësor në keqkuptimet historike dhe në besimin e gabuar në mitin romantik të shpëtimtarit heroik.

Shpeshherë ata që mbrojnë ashpër hedhjen e ushqimit në piktura, përmendin prerjen e vitit 1914 – nga sufrazhetja Mary Richardson – të Venerës me pasqyrë të Velázquezit si provë se taktikat e ngjashme funksionojnë. Derisa kjo ngjarje historike sigurisht që tërhoqi vëmendjen e shtypit, historianët e artit kanë vënë në dukje se veprimi i Richardsonit ndikoi negativisht në opinionin publik dhe se sulmet në muzeume, që pasuan, i tjetërsuan më shumë njerëzit nga kauza: sa efektivë ishin në avancimin e kauzës së të drejtës së votës për gratë – apo nëse ata në fakt e penguan atë – kjo vështirë që mund të përcaktohet. Por, ajo që sigurisht luajti rol kyç në suksesin e sufrazhetëve ishte përpjekja e tyre e bashkënduar; i fokusuar qartë në një qëllim specifik dhe të prekshëm. Pas viteve të tëra me të njëjtin truk të kryer pa pushim, sulmi i fundit i supës me kunguj ndaj Mona Lizës u ndje si i tepërt, nëse jo krejtësisht patetik. Është koha për të përdorur taktika vërtet efektive; grupet aktiviste tani duhet të gjejnë mënyrat e reja për të manipuluar vëmendjen e medias, në vend që t'i lënë mediat t'i paraqesin ato në një cep. Modelet alternative të suksesshme janë mu nën hundët e aktivistëve. Në vitin 2016, protestuesit kundër naftës i dhanë fund financimit 26-vjeçar të galerive Tate nga BP-ja [The

British Petroleum Company] duke organizuar një gamë të gjerë të shfaqjeve, ngjarjeve dhe të zaptimeve shumë imagjinate dhe krijuese në Tate Modern dhe Tate Britain. Fushata e Nan Goldinit kundër kompanisë së madhe farmaceutike Sackler family është dëshmuar gjithashtu si tepër efektive, me shumë institucione që kanë ndërprerë lidhjet me ta dhe duke e hequr emrin e tyre nga muret e galerisë. Këto demonstrime kanë qenë të suksesshme, sepse janë të fokusuara dhe specifike; objektivat janë përshtatur qartë për institucionet që kishin në cak dhe me problemet etike me të cilat përballen. Këto protesta edukojnë, pa akuzuar apo ballafaquar vizitorët e muzeumeve. Presioni ushtrohet pikërisht aty ku dhemb dhe ku të gjithë dëgjojnë. Pavarësisht nga disa pretendime abuzive dhe vetëlavdëruese se protestat jo të dhunshme kanë “riaktivizuar” veprat pasive të artit, aktivistët mjedisorë kanë përdorur kryesisht muzetë si foltore dhe veprat e artit si megafonë. Nuk është rastësi që komentet e mediave sociale rregullisht ftojnë aktivistët të ndalojnë protestat në muzeume dhe të përshkallëzojnë shënjestrimin e selive të kompanive të naftës. Ndoshta ka ardhur koha që protestuesit të fillojnë të dëgjojnë vizitorët e muzeumeve në vend që të përsërisin të njëjtën taktikë të pafytyrshme?

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Sadiku ndalet në çerekfinale të turneut të boksit në Bullgari

PRISHTINË, 8 SHKURT - Boksierja e Kosovës, Donjeta Sadiku, është ndalur në fazën e

çerekfinale së turneut ndërkombëtar të boksit "Strandja". Në turneun që po zhvillohet në Bullgari,

Sadiku humbi në meçin e dytë. Në kuadër të kategorisë deri në 60 kilogramë, Donjeta në

çerekfinale u mposht nga boksierja nga Tajlanda, Somnuek Thananya, me rezultat 3:2.



Ademi takohet me Çeferin dhe Infantinon, delegacioni i FIFA-s do ta vizitojë Kosovën

"Epoka e re"

PRISHTINË, 8 SHKURT - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, mori pjesë në Kongresin e 48 të UEFA-s në Paris si dhe në 70-vjetorin e themelimit të saj. Numri një i federatës së Kosovës ka zhvilluar takime me presidentin e UEFA-s, Aleksandër Çeferin dhe presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino.

Presidenti i FFK-së e informoi presidentin e UEFA-s rreth zhvillimeve në Federatën e Futbollit të Kosovës dhe për projektet që janë në zhvillim e sipër dhe ato që pritet të realizohen. Pjesë e rëndësishme e diskutimeve ishte projekti për stadiumin "Fadil Vokrri", ku do të bëhet ndërrimi i fushës në hibrid, në kuadër të Memorandumit të

Bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Marrëveshja mes dy institucioneve do të nënshkruhet së shpejti dhe më pas të fillojnë punimet në këtë projekt, në mënyrë që stadiumi të jetë i gatshëm për ndeshjet zyrtare të Përfaqësueses së Kosovës. "Në takimim me presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino, presidenti Ademi ka paraqitur projektet e FFK-së që janë nën mbikëqyrjen e FIFA-s, e ku brenda pak ditëve një delegacion i FIFA-s pritet ta vizitojë Kosovën për ta parë nga afër zhvillimin e projekteve dhe të futbollit në vendin tonë", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Gjatë Kongresit të UEFA-s presidenti Ademi ka zhvilluar një takim miqësor edhe me presidentin e Federatës Turke të Futbollit, Mehmet Buyukeksi dhe delegacionin e kësaj federate. Në



këtë takim, i pari i FFK-së ka shprehur dëshirën për një bashkëpunim edhe më të ngushtë ndërmjet Federatës së Futbollit të Kosovës dhe

Federatës Turke të Futbollit në të gjitha drejtimet. Në punimet e Kongresit të UEFA-s u miratuan ndryshimet në statutin e UEFA-s, raporti financiar, si dhe u caktuan

anëtarët e Shoqatës së Klubeve Evropiane dhe Shoqatës së Ligave Evropiane, të cilët do të shërbejnë në Bordin e Drejtorëve të UEFA-s.

MKRS-ja nënshkruan memorandume bashkëpunimi me federatat sportive, rritet buxheti mbi 53 %



PRISHTINË, 8 SHKURT - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka nënshkruar memorandume me federatat sportive për zhvillimin e aktiviteteve të tyre vjetore përgjatë vitit 2024. Buxheti total për këto memorandume sivjet është rritur mbi 53 % në krahasim me vitin e kaluar, ndërsa përfitues janë në total 35 federata, të gjitha ato që janë të licencuara në MKRS. "Shuma e përgjithshme e mbështetjes për federatat sportive është mbi 5.5 milionë euro. Përveç federatave që kanë qenë në listën e kategorizimit, janë nënshkruar memorandume edhe me federata të sapolicencuara, me

qëllim të nxitjes për fillimin e zhvillimit të aktiviteteve të tyre", thuhet në njoftimin e MKRS-së. Buxheti vjetor i federatave është përcaktuar përmes shumëzimit të pikës nga vlerësimi në kategorizim dhe vlerës së pikës të përcaktuar nga ministria, e cila sivjet është përcaktuar të jetë 3 000 euro për secilën kategori. Kjo është hera e parë që nënshkrimi i memorandumeve vjetore me federatat sportive është bërë kaq herët, përkatësisht në javën e parë të muajit shkurt, që nënkupton se ato do ta kenë buxhetin në dispozicion shumë më herët sesa në vitet e kaluara.

Flamurtari mposht Penzën në Kosovë, i afrohet kreut të Ligës Unike

Pejë, 8 shkurt - Penza ka pësuar humbjen e tretë në tri ndeshje, duke pësuar nga Flamurtari i Vlorës 85:94 (23:21, 17:24, 17:17, 28:32), ndërsa për skuadrën nga Vlora ishte fitorja e dytë. Periudha e parë ishte e barabartë, pasi asnjëra skuadër

nuk arrinte të shëpentej, duke përfunduar 23:21. Edhe periuda e dytë ishte e barabartë deri në tre minutat e fundit, ku u shkëputën mysafiret dhe shkuan në pushim me shifrat 40:45. Pejanet nuk u dorëzuan dhe barazuan shifrat në 49:49

por, sidoqoftë, skuadra nga Vlora pas 30 minutash ishte sërish në epërsi 57:62. Flamurtari vazhdoi me lojë të mirë dhe ngriti epërsinë në 75:89, derisa menaxhoi epërsinë në minutat e fundit dhe triumfoi 85:94. Te Penza u dalluan Peevy Elise me

28 pikë e 15 kërcime, Wingate Cayle me 24 pikë, gjashtë kërcime e gjashtë asistime dhe Saranda Daci me 17 pikë e pesë kërcime, kurse të Karon Williams me 34 pikë, tri kërcime e katër asistime dhe Asia Henderson me 28 pikë dhe 17 kërcime.



Çdo medalje olimpike në 'Paris 2024' do të ketë 18 gramë nga Kulla Eifel

PARIS, 8 SHKURT - Nuk pritej, por Kulla Eifel është protagonistja e vendosur në qendër të medaljeve olimpike dhe paraolimpike që do t'u jepen sportistëve pjesëmarrës në Lojërat Olimpike "Paris 2024". Medaljet janë paraqitur para publikut të enjten në mëngjes

në Paris. Organizatorët e Olimpiadës i janë drejtuar kompanisë operative të Kullës Eiffel për të marrë pjesë nga ky objekt prej rinovimeve që i bëhen atij. Më pas, copat e Kullës Eiffel, monumentit më emblematic të kryeqytetit, zhvisheshin, trajtoheshin dhe

llakoheshin, për t'u përdorur në projekte të tjera gjatë Lojërave Olimpike. "Nuk është thjesht një medalje. Ne u thamë atyre se duam një pjesë të saj. Ne donim që simboli i medaljes të takohej me një simbol tjetër, atë të Francës, që është Kulla Eifel", ka thënë

Thierry Reboul, drejtor ekzekutiv i markës në komitetin organizativ. "Ne donim të ofronim diçka të jashtëzakonshme dhe ta bënim këtë medalje një xhevahir. Prandaj vendosëm një pjesë të Kullës Eiffel në medalje, nga 18 gramë për çdo medalje, në



formën e një gjashtëkëndëshi, për ta vendosur si një gur të çmuar në stoli në qendër të medaljes", ka shtuar Reboul.

Sulmuesi i Gironës: Synojmë fitore ndaj Real Madridit

GIRONA, 8 SHKURT - Girona është surpriza më e bukur në pesë kampionatet më elitare të "Kontinentit të Vjetër". "Bardhekuqtë" pozicionohen aktualisht në vendin e dytë të kampionatit spanjoll të futbollit, La Liga, me plot 56 pikë, vetëm 2 më pak se kryesuesit e Real Madridit, teksa do t'i sfidojnë këta të fundit në fundjavë. Sulmuesi i Gironës, Cristhian Stuani, ka deklaruar se në këtë sfidë synohet maksimumi, derisa këtë ndeshje e ka konsideruar si një përballje direkte për titullin kampion. "Jemi shumë të emocionuar. Është një javë ndryshe sepse ne e dimë se sa e rëndësishme është kjo ndeshje. Atmosfera është e mrekullueshme dhe të gjithë në skuadër janë shumë të emocionuar por, mbi të gjitha, me këmbë në tokë sepse e dimë shumë mirë se kundër kujt do të luajmë. Të luash kundër Real Madridit me mendimin për ta parakaluar në renditje është më shumë se një motivim. Megjithatë,



është koha perfekte për të shkuar në Madrid dhe për të fituar. Ne kemi kohë që nuk ëndërrojmë, por po e shijojmë këtë sezon, këtë moment dhe besoj se të gjithë duhet ta shijojnë këtë skuadër. Kemi bërë një punë shumë të madhe", ka thënë Stuani. "Shanset tona? Pa diskutim që ne nuk jemi favoritë. Na pret një ndeshje e vështirë. Ata janë skuadra e vetme që na kanë mundur në La Liga por, theksoj, kemi punuar dhe po punojmë shumë për të zhvilluar një

ndeshje të madhe. A e mendoj golin? Patjetër që po, por nuk ka rëndësi shumë nëse shënoj unë apo jo. Rëndësi ka skuadra", ka shtuar Stuani, i cili prej gjashtë sezonesh tashmë është pjesë e "Bardhekuqve" të Gironas, teksa këtë sezon, pavarësisht prej moshës së madhe dhe konkurrencës së "bomberit" ukrainas, Artem Dovbyk ka zbritur në fushë plot 26 herë, në Kupë e Kampionat, teksa ka arritur të shënojë plot 12 gola si dhe të dhurojë dy asistime.

Bostoni lider në NBA, Golden State i jep 'leksion' Philadelphias

BOSTON, 8 SHKURT - Bostoni është gjithnjë e më në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes. Së fundmi ka mposhtur me rezultat 125-117 Atlantan. Të gjithë titullarët e Celticsit realizuan mbi 10 pikë, ku u dallua Porzingis, autor i 31 pikëve. Fitorja e dytë radhazi për Golden Staten, që mundi me rezultat 137-104 Philadelphia dhe synon zonën



"play-out". Wiggins me 21 pikë ishte shënuesi më i mirë për Warriorsin. Humbet ekipi i Clippersave, që në fushën e vet u mund 117-106 nga New Orleansi, duke lëshuar kreun në Perëndim. McCollumi me 25 pikë u dallua

për New Orleansin, ndërsa për Clippersin mungoi lojtari lider. Fitorë të lehtë korri Miami, që në shtëpi mundi me rezultat 116-104 San Antonion. Për ekipin nga Florida u dalluan Herro me 24 pikë e Adebayo me 20.

REZULTATET

Charlotte - Toronto	117-123
Washington - Cleveland	106-114
Boston - Atlanta	125-117
Miami - San Antonio	116-104
Philadelphia - Golden State	104-127
Clippers - New Orleans	106-117
Sacramento - Detroit	120-133

SHKURT

Mustafi mund të rikthehet në Serinë A

Ish-mbrojtësi i kombëtares gjermane, Shkodran Mustafi, është pranë rikthimit në Serinë A. Interesim për 31-vjeçarin ka shprehur Salernitana, i cili drejtohet nga ish-futbollisti i njohur italian Filippo Inzaghi. Ai është pa skuadër që nga vera, kur edhe i dha fund aventurës së tij me Levanten. Klubi italian ditë më parë ka nënshkruar edhe me mbrojtësin tjetër gjerman Jerome Boateng. Futbollisti me origjinë shqiptare e njuh ligën italiane pasi që më parë ka luajtur me Sampdorion. Shkodran Mustafi pritet të nënshkruajë një kontratë deri në fund të sezonit, me mundësi të zgjatjes edhe për një sezon nëse ky performon mirë dhe klubi i arrin objektivat për mbijetesë.

Çeferini do të largohet nga UEFA pas mandatit të tij

Njeriu i parë i shtëpisë më të madhe të futbollit në Evropë, UEFA, Aleksandr Çeferin, ka dhënë një informacion të rëndësishëm gjatë kongresit të mbajtur në Paris. Çeferin paralajmëroi se nuk do të jetë më pjesë e UEFA-s pas vitit 2027, kur edhe i skadon mandati. 56-vjeçari gjatë vitit 2016 ishte emëruar president i UEFA-s dhe ishte i shtati në historinë e kësaj shtëpie. Ai mori 42 vota duke e mposhtur kundërshtarin e tij, Michael van Praag. Edhe pse ishte raportuar se Çeferin do të kandidojë sërish për president, sot gjatë kongresit të UEFA-s tregoi se nuk e ka ndër mend të vazhdojë tutje pas vitit 2027.

Lingardi paraqitet te FC Seoul

Ish-mesfushori i Manchester Unitedit dhe Anglisë, Jesse Lingard, ka përfunduar një transferim te skuadra koreano-jugore, FC Seoul. Lingard ka qenë pa klub që kur i skadoi kontrata me Nottingham Forestin në fund të sezonit të kaluar. Mësohet se 31-vjeçari ka nënshkruar një marrëveshje dyvjeçare me klubin e K-League, me opsion edhe për një vit tjetër. "Gjithmonë kam dashur një sfidë ndryshe dhe të krijoj kujtime të reja në karrierën time. Unë besoj se Koreja e Jugut është vendi i përsosur për këtë", ka thënë Lingard.

Martinezi kërkon 10 milionë euro për ta rinovuar kontratën me Interin

Lautaro Martinez është kthyer prej kohësh në liderin absolut të Interit, jo thjesht një kapiten. Presidenti Zhang u ka dhënë dritën jeshile drejtuesve të klubit të bëjnë gjithçka për të mbajtur në Milano sulmuesin argjentinas, këtë e konfirmon edhe oferta e fundit që Ausilo ua ka bërë përfaqësuesve të Martinez: 8 milionë euro, plus bonuse. Aktualisht Martinez përfiton 6 milionë euro, ndërsa Calhanoglu, sa për të bërë një krahasim, përfiton 6,5 milionë euro. Me këtë ofertë Martinez do të shndërrohet në lojtarin më të paguar në skuadër por, me sa duket, as kaq nuk mjafton pasi "demi" kërkon 10 milionë euro. Vullneti i Interit është që të bëjnë një sforcë ekonomike për t'i plotësuar kërkesat e kapitenit, kjo edhe për një arsye tjetër.

Transferimet e bujshme në Formula 1

Transferimi i Hamiltonit te Ferrari është padyshim një nga transferimet më të bujshme të dekadës. Ky transferim nuk është i vetmi pasi edhe më herët ka pasur transference të tilla ku një ndër protagonistët ka qenë përsëri 7 herë kampioni i botës. Në vitin 2007 Kimi Raikkonen u largua nga McLaren dhe u transferua te

Ferrari. Ky transferim ishte një bast për italianët, të cilët u përpoqën të nisnin një epokë të re në skuadrën e tyre. Megjithatë, titulli i asaj kohe në dëm të Fernando Alonso dhe Lewis Hamiltonit në garën e fundit mbetet ende si një nga momentet më të rëndësishme për një pilot të Ferrarit në këto

dekada. Në të njëjtën vit, Fernando Alonso braktisi Renaultin për ta zënë vendin që e linte Raikkonenin te McLaren. Pas një sezoni që nuk arriti t'i konfirmonte dy titujt e tij me Renaultin dhe që nuk i lejoi t'i ndiqte gjurmët e Ayrton Senna dhe Alain Prost, Sebastian Vettel u largua nga Red Bull dhe u

transferua te Ferrari në vitin 2015, me një qëllim të qartë për ta fituar titullin e tij të pestë kampion të botës, duke u bërë kështu i pari pas Kimi Raikkonenit që do të siguronte një titull për Ferrari. Megjithatë, për shkak të performancës së dobët dhe mungesës së suksesit në pistë, gjermani nuk arriti ta

arrijë nivelin e suksesit të Michael Schumacherit në Ferrari. Ai fitoi vetëm 16 garat në 6 sezonet e tij në Maranello. Në fund të fundit, njeriu që ka shokuar botën pak ditë më parë, Lewis Hamiltoni, nisi aventurën e tij te Mercedesi në vitin 2013, duke u larguar nga McLaren pas përfundimit të bashkëpunimit me këtë skuadër.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "R&D Group" SH.P.K. me seli në Rahovec, me pronar Tahir Bala, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810733990 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "R&D Group" D.O.O. Rahovec, sa vllasnikom Tahir Bala, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810733990 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "R&D Group" L.L.C. with headquarters Rahovec, with owner Tahir Bala, has come to the decision to quit its business: 810733990 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Institucion i Arsimit dhe Aftësimi Profesional
(IAAP) "Ymer Prizreni" Prizren
e-mail: mgavazaj@hotmail.com
Nr.tel.038/20035377
facebook:"Ymer Prizreni"



Nr. Protokolit 117/2024

Në bazë të Rregullorës nr.01/2017, datë 02.02.2017, Ligjit NR.04/L-143, nenit 12 për Arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës, Drejtoresha e IAAP "Ymer Prizreni" në Prizren, vendos për pranimin e nxënësve në arsimin për të rritur dhe me këtë rast publikon këtë:

KONKURS**EKONOMI**

- 1.Kontabilitet e tatime..... 1 paralel 24 nxënës
2.Tregti me pakicë e shumicë..... 1 paralel 24 nxënës

HOTELERI

- 1.Asistent restoranti.....1 paralel 24 nxënës

TEKNOLOGJI USHQIMORE

- 1.Teknologji ushqimore.....1 paralele 24 nxënës

ADMINISTRATE

- 1.Administrim dhe shërbime të zyrës..... 1 paralel 24 nxënës

Kushtet:

Dokumentacioni (dëftesa e shkollimit paraprak, certifikata e lindjes, dhe letërnjoftimi i fotokopjuar).

Pagesa bëhet sipas rregullores së MASHT-it Nr.11/2011 Dt.:30.12.2011 dhe Rregullores për tarifa, taksa, ngarkesa dhe gjoha nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale nr.01/11.

1. Për regjistrimin e vitit për një klasë: 100 €
2. Praktika profesionale 50 €
3. Lënda me shkrim dhe me gojë 10 €
4. Lënda me gojë 8€
5. Për diplomë (përfundimi i shkollimit): 50€
6. Provime diferenciale 10€

Vijueshmëria në mësim

Kandidatët e pranuar janë të obliguar që t'i ndjekin 18 javë mësimi nëse klasa e profilit përkatës numëron mbi 15 nxënës, dhe në fund t'i nënshtrihen testit vlerësues në të gjitha lëndët e parapara për arsimin për të rritur.

Për klasë ku numri i nxënësve është nën 15 nxënës, organizohet mësimi konsultativ.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në gazetë.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shkumbin J. Hetemi B.I. Auto Parking Kushtrimi, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811541037 si dhe Vulën e Biznesit.

- Biznesi Teuta-T SH.P.K. me nr. 810176223 nga Rahoveci, shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit (të humbur).

- "Swiss Corp" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330336596.

- Rinor Badalli shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu" Dëshmorët e Zhurit " Zhure.

- Besmir Regjaj shpall te pavlefshme certifikatën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Labinot Jasharaj shpall te pavlefshme dëftesën e kl XIII dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Lirim Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- Mirela Balaj Metalijaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Hysni Zajmi"

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A në Prishtinë, me datë 09.02.2024 shpall këtë:

KONKURS

Titulli i pozitës: Zyrtar Ligjor – 1 pozitë

Institucioni: Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A – Prishtinë

Titulli i Mbikëqyrësit/Raporton tek: Sekretari i Ndërmarrjes

Orari i Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)

- Asiston në përbushjen e detyrave të përgjithshme të Shërbimit Juridik;
- Merr pjesë në hartimin, plotësimin dhe ndryshimin e akteve të brendshme juridike;
- Përgatit opinione, shkresa, përgatit shpallje të konkurseve, përcjell procedurat e rekrutimit, kontratat, marrëveshje dhe dokumente të tjera ligjore të nevojshme për administrim efektiv të ndërmarrjes;
- Në bazë të nevojave të ndërmarrjes, jep këshilla ligjore, interpreton dhe mban përgjegjësi për të gjitha interpretimet që kërkon personeli i ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë.

Shkathtësitë e kërkuara: (aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga juridik dhe administratës publike; Njohuri e gjuhës angleze e preferueshme;
- Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point etj) dhe internetin;
- Shkathtësi për shqyrtimin e lëndëve, hartim të propozimeve për përmbarim, ankesave dhe të gjitha shkresave të nevojshme për kompaninë;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik;
- Dy (2) vite përvojë pune profesionale;

Konkursi është publikuar më datë 09 shkurt 2024 dhe mbyllet më datë 23 shkurt 2024.

APLIKACIONI: Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

- Dëshminë e kualifikimit shkollor;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (*Vërtetimi ose kontrata e punës*);
- Dy rekomandime (*nëse keni*);
- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (*nëse ekzistojnë të tilla*);
- Dokumentin e identifikimit–letërnjoftimi i fotokopjuar;
- Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.

MËNYRA E APLIKIMIT:

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në pliko (zarfë) të mbyllur në arkivën e KRM "Pastrimi" SH.A, Rr. "Tahir Zajmi", Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. "Tahir Zajmi", nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

KUSHTET E PJESËMARRJES NË KONKURS:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës së moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM "Pastrimi" SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

VËREJTJE:

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit.

Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Na osnove člana 8. Zakona br. 03/L-212 o radu, član 4 Administrativnog uputstva br. 07/2017 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, Datum 09.02.2024, Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" S.A. u Prištini, objavljuje:

KONKURS

Naziv pozicije: Pravni referent – 1 radno mesto

Institucija: Regionalno preduzeće za otpad (KRM) "Pastrimi" Sh.A – Priština

Zvanje supervizora/Izveštava: Sekretar kompanije

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje imenovanja: Sa neodređenim rokom

Dužnosti i odgovornosti: (kratak opis glavnih zadataka)

- Pomaže u ispunjavanju opštih dužnosti Pravne službe;
- Učestvuje u izradi, dopuni i izmeni internih pravnih akata;
- Priprema mišljenja, pisma, priprema oglase za konkurse, prati procedure zapošljavanja, ugovore, sporazume i druge pravne dokumente neophodne za efikasnu administraciju preduzeća;
- Na osnovu potreba kompanije, pruža pravne savete, tumači i preuzima odgovornost za sva tumačenja koja zahtevaju zaposleni u kompaniji;
- Obavlja i druge poslove po zahtevu neposrednog rukovodioca.

Potrebne veštine: (veštine i veštine potrebne za ovaj posao)

- Odlično i sveobuhvatno stručno poznavanje prava i javne uprave; Poželjno poznavanje engleskog jezika;
- Poznavanje dobrog rada na računaru korišćenjem programa (Microsoft Word, Ekcel, Power Point i dr.) i Interneta;
- Veštine za razmatranje predmeta, izradu predloga za izvršenje, žalbi i svih potrebnih dokumenata za kompaniju;
- Istraživačke, analitičke, evaluacione veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost održavanja kvaliteta rada čak i pod pritiskom.

Obrazovanje, stručna sprema i radno iskustvo: (potrebne kvalifikacije i iskustvo za ovaj posao)

- Univerzitetska diploma, Pravni Fakultet;
- Dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva;

Konkurs je objavljen 09 Februar 2024 godine i zatvara se 23 Februar 2024 godine.

APLIKACIJA: Uz prijavu se prilažu i potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

- Dokaz o školskoj spremi;
- Dokaz o radnom iskustvu (Potvrda ili ugovor o radu);
- Dve preporuke (ako imate);
- Kopije poslednja dva uzastopna izveštaja o evaluaciji poslova (ako ih ima);
- Identifikacioni dokument – fotokopirano obaveštenje;
- Potvrda suda da niste pod istragom

NAČIN PRIMENE:

Obrazac prijave se prima i dostavlja u zatvorenoj kovrti u arhivu KRM „Pastrimi“ S.A, ul. „Tahir Zajmi“, br. 5, Priština.

Prijava putem pošte: Prijava sa dokumentima se može dostaviti i poštom na adresu: Ul. "Tahir Zajmi", br.5, Priština, 10000. Prijave poslate poštom moraju biti obilježene poštanskim žigom poslednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate poštom, koje nose poštanski žig na pošiljci učinjenoj poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete u obzir ako stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu nakon ovog roka i one koje su nepotpune neće se uopšte razmatrati.

USLOVI UČEŠĆA U KONKURSU:

Svi punoletni građani Republike Kosovo koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, imaju neophodnu obrazovnu pripremu i profesionalnu sposobnost za obavljanje svojih dužnosti i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za dotičnu poziciju imaju pravo da se prijave.

KRM "Pastrimi" S.A nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja prijave svih lica muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu.

BELEŠKA:

NEKOMPLETNE PRIJAVE I DOKUMENTACIJA PREMA USLOVIMA NAVEDENIM U OVOM KONKURSU KAO I ONE PRISLEPE NAKON KONKURSNOG ROKA NEĆE SE RAZMATRATI.

Biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana, od dana objavljivanja.

Za važnije informacije možete se obratiti na br. telefon: +383 (0) 38 603 191

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

